

NË MES SHQIPËRISË DHE EVROPËS KRIMI I ORGANIZUAR¹

Vështirësia për të kryer luftën kundër rrjeteve kriminale
sipas kërkesave të BE-së

Ernest BUNGURI

Temë diplome për masterin e gazetarisë evropiane

**Qendra Universitare e Gazetarisë
Universiteti “ ROBERT SHUMAN “, Strasburg**

Drejtuesi i temës Nikolas Gros-Verheyde

Viti akademik 2002-2003

.....

Kapitulli II

Dobësia shqiptare

2-1. Efikasiteti nuk shpërblehet

Rasti i Xhavit Shalës dëshmon se në Shqipëri ekziston vullneti për të luftuar krimin e organizuar, por ky vullnet mungon fare në vendimet e drejtuesve të vendit. Historia e një drejtori policie që i mungon mbështetja.

Takimin e kemi caktuar në një lokal rreth orës 19 të darkës, thjesht për t'i dhënë kohë atij që të përfundojë disa shënime për librin e tij të fundit. Në Shqipëri shumë njerëz preferojnë të bisedojnë në kafene, sesa në zyra. Padyshim, kjo tendence vjen nga koha e komunizmit, ku të gjithë institucionet gëlonin nga përgjuesit. Lokali gjendet në afërsi të godinës së Ministrisë së Rendit Publik, pranë një rruge të vogël që merr pakëz përpjetë në rrënojat e një kalaje të vjetër të Tiranës. Brenda ndodhen shumë klientë. Që në hyrje atë e dallon menjëherë. Një dosje nën sqetull, pa uniformë, i thjeshtë, me një buzëqeshje në fytyrë. Është pikërisht ai, Xhavit Shala, analist kriminal, pranë Ministrisë Rendit Publik. Ai

¹ Titulli ne origjinal : **ENTRE L'ALBANIE ET L'EUROPE: LE CRIME ORGANISE**

II -LA DÉFICIENCE ALBANAISE.

2.1. L'EFFICACITÉ EST MAL PAYÉ

L'exemple de Xhavit Shala montre que la volonté de combattre le crime organisé existe en Albanie. Mais elle n'est guère visible dans les décisions des dirigeants du pays. Histoire d'un directeur de police en mal de soutien

pëlqen të ulemi në një tryezë në fund të lokalit, larg zhurmave dhe veshëve më shumë kureshtare se ç'duhet.

Në vitin 1984 Xhaviti përfundon studimet e larta për punët e brendshme (me rezultate të shkëlqyera). E fillon punën si oficer policie në Elbasan, një qytet në qendër të Shqipërisë. I pasionuar për letërsinë, diplomohet për gjuhë dhe letërsi shqipe në vitin 1994. Kjo nuk e pengon të bëhet Drejtor i Shërbimeve Sekrete të qytetit. Tri vjet më vonë, gjatë trazirave që përfshinë gjithë vendin pas rënies së firmave piramidale, thirret në kryeqytet ku emërohet Drejtor në Shërbimin Informativ Kombëtar. Atje qëndron deri në vitin 1999, kohë kur Spartak Poçi, Ministri i ri i Brendshëm, synon të përfitojë nga përvoja e tij për të luftuar krimin.

Të eliminohen “bandat e majta”.

Në atë kohë një nga ish- drejtuesit e shërbimeve sekrete bëhet kështu Drejtor Qendror i Policisë Kriminale dhe, menjëherë, ndërmerr zbatimin e një strategjie që nis të sjellë frytet e para: “Nisa të luftoj organizatat kriminale që në atë kohë mbiquheshin “bandat e majta”. Ato e mbanin këtë emër në bazë të kontributit të tyre në rrëzimin e qeverisë demokratike, kontribut që e ndihmoi PS të rimerrte pushtetin. Kjo u jepte atyre të drejtën për të terrorizuar gjithë njerëzit”. Askush nuk mund ta ndalojë Xhavitin në këtë punë. Këto organizata janë tepër të bujshme për t’u marrë në mbrojtje. Kryhen arrestime dhe burgosje, si p.sh ato të bandës së Zani Caushit, një vrasës, i cili vetëquhej “Shpëtimtari i Vlorës”, qytet jugor i Shqipërisë, ku kishin zanafillën e tyre trazirat.

Por ky efikasitet nuk u shkon për shtat të gjithëve: më 9 nëntor 2000, vetëm disa ditë pas një konference shtypi ku u konfirmua fundi i “bandave te majta”, ministri i brendshëm shkarkohet, Xhaviti njoftohet nga ministri pasardhës, se duhet të lerë detyrën e tij për të shkuar në Fier, një tjetër qytet jugor i Shqipërisë , ku ai merr detyrën si drejtor policie.

Tri strategjitë e luftës kundër kriminit.

Xhaviti nuk dorëzohet. “Kur mbërrita unë, Fieri ishte epiqendra e të gjitha të këqijave: trafik e prodhim droge, trafik e shfrytëzim të qenieve njerëzore, shitje armësh zjarri. Kishim një mal me punë përpara”, shprehet ai.

“Që prej 1994 zona jonë mbante vendin e parë në Shqipëri për prodhimin e kanabis sativa”, shton Rrapi Vogli, zëdhënës i policisë së Fierit. Drejtori i ri i Policisë i futet punës dhe përcakton tri strategji lufte: kundër drogës, trafikut të qenieve njerëzore dhe të armëve. Fillohet me sensibilizimin. Në janar 2001 një Konferencë Rajonale mbledh prefektët, kryepleqtë, përfaqësuesit e arsimit, të shëndetësisë, të pushtetit lokal, përfaqësuesit e SHIK-ut, të prokurorisë e gjykatës. Sapo vihen piketat e bashkëpunimit, fillon veprimi i pushtetit në të gjithë zonën. Gjithçka kryhet midis Janarit dhe Prillit, periudha e kultivimit të kësaj bime. “Në atë kohë hashashi mbillej sikur të ishte grurë dhe veprimi ynë i dha shumë shpejt frytet e tij” kujton Xhaviti. “Brenda një viti kultivimi u ul 60 herë dhe qindra mijë rrënjë u asgjësuan”, shton më tej Rrapi Vogli.

Rezultatet janë akoma më të mira për sa i përket grumbullimit të armëve. E njëjta formulë u përdor për sensibilizimin e popullatës dhe bashkëpunimi ishte i gjerë. “Mblidhen 7% më shumë armë se sa sasia e grabitur në zonën e Fierit. Kjo tregon se, që nga 1997, armët qarkullonin shumë herë brenda vendit”, vijon Xhaviti. Gjatë trazirave të 1997 të gjitha

depot ushtarake u grabitën nga popullata. Shumica e njerëzve e bënë këtë për t'u ndjerë më të sigurt në një vend që u zhyt në një anarki totale.

Një komisariat si qendër pritje

Në shtator 2001 organizohet një konferencë tjetër. Këtë herë për të luftuar kundër trafikut të qenieve njerëzore. “Shkuam në 42 komuna të Fierit dhe organizuar biseda në shkolla në shkolla për të sensibilizuar të rinjtë ndaj mashtrimeve të trafikantëve. Ndërsa qëllim tjetër i këtyre bisedave ishte ndryshimi i mentalitetit të njerëzve në mënyrë që ata t'i shihnin prostitutat si viktima”, shprehet zëdhënësi. Por jo gjithçka mbaron këtu.

Xhaviti krijon Qendrën e Pritjes dhe Mbrojtjes së viktimave të trafikut të qenieve njerëzore. E para në llojin e saj, kjo qendër vendoset brenda rrethimit të komisariatit. “Biznesmenë të vegjël të qytetit na ndihmuan për të sjellë tri kontejnerë të përdorur në 1999 për refugjatët kosovarë. Qytetarët na sollën, sipas mundësive të tyre shtretër, batanije, një televizor dhe disa karrige”, rrëfen Rrapi Vogli. Njëri nga kontejnerët u përdor si sallë leximi dhe pushimi si dhe për 28 vizita nga familjet e viktimave. Ndërsa dy të tjerët shërbenin për fjetje. “I gjithë blloku ishte i ndarë nga komisariati dhe këqyrej me kamera”, shton Xhaviti. Sapo u krijua qendra, forcat e policisë së Fierit grumbulluan viktimat e trafikut që riktheheshin në Shqipëri nga të gjitha pikat kufitare. Femrat që pranonin ndihmën rrinin në qendër nga dy jave deri në dy muaj, kohë e mjaftueshme për t'i marrë në mbrojtje dhe për të nisur procedurën për arrestimin e tutorëve. Më pas viktimat ktheheshin pranë familjeve të tyre, ose transferoheshin në qendra të tjera pritjeje, si ajo e IOM-it. “Në qendër janë trajtuar 34 femra. Gjatë kësaj periudhe u penalizuan 107 tutorë, vetëm në zonën e Fierit, e thënë ndryshe 2 herë më shumë se sa sasia e tutorëve në rang kombëtar”, rrëfen Xhaviti.

Një Qendër Studimesh për Sigurinë Kombëtare

Efikasiteti i policisë së Fierit shkakton bujë. Kanale televizivë të huaj si RAI, TF1 si dhe mediat gjermane e belge dërgojnë në Fier ekipe gazetarësh. Shefi i OSBE-së, Gert Ahrens, merr pjesë në përrurim, por jo Ministri i Brendshëm. “Ai urdhëroi që vajzat të mos ushqeheshin më me shpenzimet e policisë. Në këto kushte i bëmë apel biznesit vendor i cili na siguroi 5 euro në ditë për çdo vajzë”, kujton Xhaviti.

Drejtori i ri i policisë godet gjithnjë e më shumë dhe gjithnjë e më fort. Kriminelët i kundërpërgjigjen me dy atentate të cilave Xhaviti i shpëton. Nga ana tjetër ai nuk ka fuqi të dalë mbi urdhrat e eprorëve të tij. Gjatë një operacioni një trafikant droge arrestohet në banesë me 2 kg heroinë. “Ka disa kriminelë në Fier që kanë financuar fushatat elektorale të disa deputetëve, por trafikantët në fjalë kishte lidhje edhe më të rëndësishme.”, rrëfen ai. Në prill 2002, dy ditë para procesit të trafikantit në fjalë, Xhavitit i mbërrin një shkresë nga Ministri i Brendshëm : “Keni punuar shumë, por duhet ta lini këtë detyrë menjëherë në pritje të një emërimi tjetër”. Asnjë shpjegim. Dy ditë më vonë në procesin gjyqësor trafikanti lirohet me arsyen se “dikush tjetër i ka futur heroinë në banesën e tij”. “Atij nuk do t'i ishte dhënë pafajësia nëse unë do të isha sërish drejtor policie”, shton Xhaviti i zhgënjyer.

Pas largimit të tij qendra mbyllet me shpejtësi. “Shefi i sektorit antitrafik dhe zëvendës-drejtori u zëvendësuan menjëherë”, rrëfen Rrapi Vogli, që, gjithsesi vazhdon të jetë zëdhënësi i policisë Fier. Një muaj rresht mbështetur edhe nga mediat, Xhavit mbetet

në pritje të emërimit të premtuar. “Më në fund më gjetën një vend pune në Ministri, si analist kriminal, por në Shqipëri, kjo detyrë nuk ka ndonjë rëndësi të madhe”, shton ai.

Megjithatë ai përsëri nuk dorëzohet. Në 2002 krijon Qendrën e Studimeve për Sigurinë Kombëtare, ku, bashkë me kolegët e tij, përpunon strategji të reja për të luftuar krimin. Kësaj veprimtarie i shtohet dhe një libër që ai sapo ka botuar me titull “Siguria kombëtare dhe sfidat e integritetit”. Aty ai flet për gjakmarrjen, plagë e shoqërisë shqiptare si dhe për trafiket e llojet e tjera të krimeve. “Nuk është ende koha për të shkruar mbi lidhjet midis trafikantëve dhe politikanëve. Sigurisht, do ta bëj një ditë këtë, por kur të ndihem më i sigurt”, garanton ai.

.....